



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1080/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Adem Breznica, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar Apeli Anr.1080/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Adem Breznica, kandidat për Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, në Vendvotimet: 0901E/06R dhe 0903E/03D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimet të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit paraqitur nga Adem Breznica, kandidat për Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar rinumërimin, për vendvotimet: 0913E/01D, 0901E/05R, 0901X/07R, 0901E/01R, 0902E/01R, 0902E /02R, 0902E /03R, 0902E /04D, 0908E/01R, 0908E/02D, 0901E/01R, 0901E/16R, 0912E/01R dhe 0912E/02D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Adem Breznica nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, në të cilën thekson nga vendvotimet e mëposhtme nuk i janë numëruar votat ne tersi dhe i janë keq numëruar duke i kaluar kandidateve tjerë ne Formularin e Rezultateve te Kandidatit dhe i janë prishur me qellim për te mos arritur kuotën e duhur te zgjedhjes ne asamblenë komunale te Fushe Kosovës. Parashtruesi i apelit thekson se ne vendvotimin 0913E/01D ku ka te afërm dhe familjar ka vetëm 3 vota, ne vendvotimin

0901E/05R thekson se ka zero vota përkundër qe ka kushëri e familjar, ne vendvotimin 0901X/07R ne FRK janë vendosur dy vota ne mes te vijës ndarëse te numrit 17 dhe numrit tjetër 18 duke mos u llogaritur votat fare, ne vendvotimin 0901E/01R ne këtë vendvotim ka vetëm një vote ndërsa këtu ka familjar te tij , ne vendvotimin 0901E/06R ne këtë pike nuk duket shifra e saktë sa është shënuar ne FRK 84 apo 4, ne vendvotimet 0902E/01R, 0902E /02R, 0902E /03R, 0902E /04D i janë shpallur votat e pavlefshme, 0908E/01R ka vetëm 15 vota ne FRK, ne vendvotimin 0908E/02D ka zero vota, ne vendvotimet 0901E/01R dhe 0901E/16R thekson se ka mungesa te votave, ne vendvotimin 0903E/03D ne këtë pike ka me tepër se 20 fletëvotime te dorëzuara te dorëzuara 770 se sa te pranuar 750 prandaj dyshon se ka mbushje te kutive te votimit për kandidat te preferuar, 0192E/02D ky vendvotim thekson se nuk ekziston ndërsa është publikuar tek rezultatet e skanuara ne faqen e KQZ-se ku këtu figurojnë 6 vota, 0912E/01R dhe 0912E/02D ka shume vota te prishura.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të votave të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushe Kosovës Adem Breznica, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, me provat e ofruara nga pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë për Vendvotimet: 0901E/06R, dhe 0903E/03D ; dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Apeli në pikën IV të dispozitivit është i pa bazuar për arsye se nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal në Fushe Kosovë Adem Breznica, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Fushë Kosovë, për vendvotimet: 0913E/01D, 0901E/05R, 0901X/07R, 0901E/01R, 0902E/01R, 0902E /02R, 0902E /03R, 0902E /04D, 0908E/01R, 0908E/02D, 0901E/01R, 0901E/16R, 0192E/02D, 0912E/01R dhe 0912E/02D është i pa bazuar për faktin se nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të

LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidatin në fjalë, për faktin se thëniet e tij janë vetëm supozime dhe sipërfaqësore dhe jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për të cilën ai pretendon për mungesë të votave për te në vendvotimet e pretenduara.

Ndërsa për vendvotimin e pretenduar se vendvotimi me numër 0192E/02D nuk ekziston, dhe në këtë vendvotim i ka 6 vota, Paneli gjeti se nuk përjashtohet mundësia e gabimit teknik në shënimin e këtij vendvotimi por Paneli nga hetimi i bere ka gjetur se ky vendvotim është me numër 0912E/02D ndërsa i njëjti në këtë vendvotim i ka 6 vota ashtu siç pretendon, pra votat e tij janë ashtu siç i pretendon në ankese.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

Anr.1080/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.